

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 928/28 Prot.

Datë 28.04.2022

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 7791 Prot.

Datë 28.04.2022

UDHËZIM

Nr. 7, datë 28.04.2022

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 11.02.2022 "PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 6 dhe nenit 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012 "Për peshkimin", të ndryshuar dhe të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të pikës 5, të VKM nr. 101, datë 9.2.2022, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2022", Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 1, datë 11.02.2022 "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në kreun I, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Emërtimi i masës mbështetëse nr. 9 zëvendësohet me formulimin:

"Për rinovimin e infrastrukturës së anijes së peshkimit. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të blerjes, por jo më shumë se 13 500 000 (trembedhjetë milion e pesëqind mijë) lekë për anije peshkimi të pajisur me leje të vlefshme peshkimi tregtar dhe jo më shumë se 20 milion lekë për subjekt. Rinovimi i anijes së peshkimit përfshin:

- i. Blerjen dhe instalimin e motorit kryesor, por jo më shumë se 7 000 000 (shtatë milion) lekë;
- ii. Blerjen e pjesëve të këmbimit për motor, si kollodok, biella, bronxina, këmisha, fasho, pistona, testato dhe set guarnicionesh, por jo më shumë se 3 500 000 (tre milion e pesëqind mijë lekë);
- iii. Blerjen dhe instalimin e motorit ndihmës (gjeneratori detar), por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë;
- iv. Blerjen dhe instalimin e vinçit të anijes, por jo më shumë se 3 500 000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë. Vinçi përfshin edhe agregatet, hidromotorin, pompë vaji, friksion, multiplikator dhe tubacionet;

- v. Dokimi periodik i anijes, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milion) lekë. Dokimi periodik, sipas kushteve të klasit, përfshin ngritjen dhe uljen nga kantieri, pastrimin dhe heqjen e bojës së vjetër, blerje boje, stuko, protektor (zinqe), riparim aksi helike.
 - vi. Riparim i përgjithshëm i anijes, por jo më shumë se 9 000 000 (nëntë milion) lekë. Në riparimin e përgjithshëm, përveç zërave të përcaktuara në dokimin periodik sipas nënpikës “v”, përfshihen dhe zëvendësim llamarine, ndërrim dërrase dhe impianti elektrik”.
- b) Emërtimi i masës mbështetëse nr. 10 zëvendësohet me formulimin:
“Mbështetje për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe/ose tregjeve të kafshëve të gjalla për shoqëritë tregtare me kapital 100% shtetëror, në vlerën jo më shumë se 30 000 000 (tridhjetë milion) lekë/subjekt.”
2. Në kreun IV, pas paragrafit të parë, bëhet shtesa “Aplikimet për masat mbështetëse nr. 8 dhe 9 do të bëhen nga data 2.5.2022 deri në datën 2.6.2022”.
3. Në kreun VIII, masa 9, bëhen ndryshimet dhe shtesat si vijon:
- a) Emërtimi i masës 9, zëvendësohet me formulimin:
“Masa 9. Për rinovimin e infrastrukturës së anijes së peshkimit. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të blerjes, por jo më shumë se 13 500 000 (trembedhjetë milion e pesëqind mijë) lekë për anije peshkimi të pajisur me leje të vlefshme peshkimi tregtar dhe jo më shumë se 20 milion lekë për subjekt. Rinovimi i anijes së peshkimit përfshin:
- i. Blerjen dhe instalimin e motorit kryesor, por jo më shumë se 7 000 000 (shtatë milion) lekë;
 - ii. Blerjen e pjesëve të këmbimit për motor, si kollodok, biella, bronxina, këmisha, fasho, pistonat, testato dhe set garnicionesh, por jo më shumë se 3 500 000 (tre milion e pesëqind mijë lekë);
 - iii. Blerjen dhe instalimin e motorit ndihmës (gjeneratori detar), por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë;
 - iv. Blerjen dhe instalimin e vinçit të anijes, por jo më shumë se 3 500 000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë. Vinçi përfshin edhe agregatet, hidromotorin, pompë vaji, friksion, multiplikator dhe tubacionet;
 - v. Dokimi periodik i anijes, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milion) lekë. Dokimi periodik, sipas kushteve të klasit, përfshin ngritjen dhe uljen nga kantieri, pastrimin dhe heqjen e bojës së vjetër, blerje boje, stuko, protektor (zinqe), riparim aksi helike;
 - vi. Riparim i përgjithshëm i anijes, por jo më shumë se 9 000 000 (nëntë milion) lekë. Në riparimin e përgjithshëm, përveç zërave të përcaktuara në dokimin periodik sipas nënpikës “v”, përfshihen dhe zëvendësim llamarine, ndërrim dërrase dhe impianti elektrik”.
- b) Në nënndarjen “iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR”, pas shkronjës “j” shtohen shkronjat “k” dhe “m”, me formulimin e mëposhtëm:
- “k. Për dokimin periodik duhet të paraqiten dokumentat e mëposhtme:
- Lista e zërave të punimeve për njësi dhe volum shoqëruar me specifikimet teknike, e miratuar nga Regjistri Detar Shqiptar (RDSH);

- 3 oferta origjinale me datë, firmë dhe vulë për të gjithë zërat e punimeve, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikuesin dhe me njëri-tjetrin;
- Dokumentin në fund të punimeve, ku RDSH certifikon punimet e kryera të firmosur nga inxhinieri i RDSH dhe të konfirmuar nga inxhinieri i kantierit, sipas situacionit të punimeve të miratuar prej tij, i cili përmban zërat e punimeve dhe volumet përkatëse;
- Situacioni i punimeve të realizuara do t'i bashkelidhet fatures fiskale dhe/ose tatimore për kryerjen e punimeve nga subjekti i ofertës fituese;

Inspektoret e AZHBR nëse është e nevojshme rakordojnë me RDSH gjatë kryerjes së punimeve, kur inspektoret e RDSH kontrollojnë ecurinë e punimeve, për të evidentuar zërat për punimet e fshehta.

m. Për riparimin e përgjithshëm të anijes së peshkimit duhet të paraqiten dokumentat e mëposhtme:

- Lista e zërave të punimeve për njësi dhe volum shoqëruar me specifikimet teknike, e miratuar nga Regjistri Detar Shqiptar (RDSH);
- 3 oferta origjinale me datë, firmë dhe vulë për të gjithë zërat e punimeve, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikuesin dhe me njëri-tjetrin.
- Në momentin që subjekti shpallet fitues potencial, përpara fillimit të punimeve, listën e zërave të punimeve të miratuar nga RDSH të firmosur nga inxhinieri i RDSH dhe të konfirmuar nga inxhinieri i kantierit, i cili certifikon punimet e nevojshme (preventivi i punimeve);
Kontrata lidhet mbi bazën e zërave të punimeve të parashikuara, çmimet dhe volumet për njësi bazuar në çmimet më të ulëta sipas zërave të të gjithë ofertave të paraqitura nga aplikantët. Vlera që do të mbeshtetet nga AZHBR nuk mund të jetë më e madhe se vlera e parashikuar në preventivin paraprak;
- Lista e zërave të punimeve duhet të jete e shoqëruar nga raporti i vlerësimit nga inxhinieri i kantierit dhe inxhinieri i RDSH për sipërfaqen dhe trashësinë e llamarinës ose drurit (në rastin e anijeve prej druri) që nevojitet të zëvendësohet;
- Dokumentin në fund të punimeve, ku RDSH certifikon punimet e kryera të firmosur nga inxhinieri i RDSH dhe të konfirmuar nga inxhinieri i kantierit, sipas situacionit të punimeve të miratuar prej tij, i cili përmban zërat e punimeve dhe volumet përkatëse;

Situacioni i punimeve të realizuara do t'i bashkelidhet faturës fiskale dhe/ose tatimore për kryerjen e punimeve nga subjekti i ofertës fituese. Inspektorët e AZHBR, nëse është e nevojshme rakordojnë me RDSH gjatë kryerjes së punimeve, kur inspektoret e RDSH kontrollojnë ecurinë e punimeve, për të evidentimin e zërave për punimet e fshehta.

Ne rastin kur riparimet e përgjithshme kryhen në kantiere jashtë Shqipërisë, punimet e kryera certifikohen nga kantieri i vendit të huaj dhe Regjistri Detar i vendit të huaj ose RDSH".


4. Në kreun IX, pas pikës 9, shtohet pika 10, me me formulimin e mëposhtëm:

“10. Për masën 9, për zërat e parashikuar në nënndarjet “ii”, “v” dhe vi” verifikimet në vend para pagesës bëhen pas kryerjes së punimeve, dhe nuk bëhet kontroll expost.”

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**

FRIDA KRIFCA



**MINISTRI I FINANCËVE
DHE EKONOMISË**

DELINA IBRAHIMAJ

